

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.H. nga Prishtina, për shkak të veprës penale grabitje në tentativë nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 20 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit K.H., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.200/13 datë 11.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 07.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit K.H. nga Prishtina, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.200/13 datë 11.12.2017, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarin K.H. e liron nga akuza:

Sepse: i akuzuari K.H. me qëllim që vetës ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme duke përdorur dhunën dhe kanosjen me datë 24.09.2008 rreth orës 08,40 minuta në Prishtinë në rr “...” në Bregun e Diellit ku i akuzuari ka hyrë në lokalin “Western Union”, me revole të tipit të panjohur, me ngjyrë të zezë dhe ia kishte drejtuar të dëmtuarës A.I. punëtore në këtë lokal. E cila ishte duke pastruar lokalin dhe më pas e kishte kapur për dore dhe për flokëve, duke kërkuar para dhe çelësat për t’ia hapur derën ku gjenden parat, mirëpo dera ka qenë e mbyllur, ku ishte i dëmtuari S.S. menaxheri i lokalit me ç rast ka lëvizur nga brenda dhe ka bërë titur me zë, dhe në atë moment i akuzuari me revole është larguar, me shpejtësi ka dalur nga lokali dhe është larguar.

Me çka kishte për të kryer veprën penale Grabitje në tentativë nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 20 të KPK,

Shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.200/13 datë 11.12.2017, të akuzuarin K.H. e ka shpallur fajtor për veprën penale Grabitje në tentativë nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 20 të KPK dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 4 (katër) viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. Është detyruar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale aq

sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 (njëqind) euro të cilën duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit A.I. dhe S.S. kanë heqë dore nga propozimi për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit K.H. av. B.E., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin K.H. ta liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.122/18 të dt.30.03.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e mbrojtësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke theksuar se është shkelur neni 1 ku garantohet se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet. Po ashtu edhe neni 3 par.2 i KPP përcakton se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të Ligjit Penal interpretohen në favor të pandehurit. Kjo pasi e dëmtuara- dëshmitarja A.I. në shqyrtimin kryesor nuk ka mundur ta identifikoj në sallën e gjykimin personin e akuzuar dhe se me rastin e identifikimit në sallë ka theksuar se identifikimi në përqindje është 50% me 50%. Mëdyshjet edhe përkundër asaj që i kishte edhe kryetari i trupit gjykues që vërtetohet në faqen 3 pasusi 32 ku ndër të tjera thekson “meqë e dëmtuara ka ndryshuar deklaratat e dhëna në fazat e ndryshme të procedurës penale” e që përkundër këtyre kundërthënieve ia ka falur gjykata besimin kësaj dëshmitareje. Personat të cilët kanë qenë së bashku me të akuzuarin me rastin e identifikimit nuk janë bërë konformë dispozitave të procedurës penale pasi asnjëri nga ta nuk ka pas veti të ngjashme fizike me të akuzuarin K., kanë pasur dallime të mëdha në moshë dhe asnjëri nuk ka pasur mjekër me të cilën dëshmitarja kishte bërë identifikimin e K. në polici e që vërtetohet me procesverbalin mbi identifikimin e personit e ku thuhet se dëshmitares i tregohen 5 persona të moshave dhe gjatësive e dukjeve të ndryshme. Shkelje tjetër kemi nga neni 101-104 me rastin e ngritjes së aktakuzës nga prokuroria ku aktakuza është ngritur pa aktvendim për fillim të hetimeve e ku pretendohet se vepra është kryer me 24.09.2008 ndërsa akuza është ngritur me 02.04.2013 pra kemi një kohë prej kryerjes së veprës e deri në ngritje të aktakuzës prej 5 viteve. Kallëzimi penal policia e ka dorëzuar në prokurori me datë 22.10.2008 dhe prej kësaj date nuk ka ndërmarrë as edhe një veprim të vetëm lidhur me këtë rast ndërsa aktakuza është ngritur mbi bazën e disa provave që kanë qenë të pa favorshme për të akuzuarin e këtu është fjala për zhdukjen e provës kryesore të këtij kallëzimi penal që është CD e kamerës nga vendi i ngjarjes e që do të vërtetonte se i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është shpall fajtor. Asnjëherë nuk është marrë

në pyetje nga ana e prokurorisë duke ngritur akuzë pa prova të pranueshme dhe pa aktvendim për fillim të hetimeve. Edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se i tërë përshkrimi i gjendjes faktike është një skenar i cili nuk është i besueshëm pasi ka kundërthënie. Sipas dëshmimeve të dëshmitarëve nuk përshkruhet asnjë veprim konkret me të cilën do të vërtetohej se K.H. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Dëshmitarja A.I. ka pranuar se nuk ka mundur ta shikoj në fytyrë sulmuesin, se nuk ka mundur ta bëjë identifikimin e tij as në bazë të video incizimit ndërsa e identifikon përmes fotografive në polici në një proces ku ka pasur shkelje procedurale gjatë identifikimit. Pas ballafaqimit e dëmtuara ka theksuar “se nuk di çka me than” duke shtuar se këtë përshkrim e ka bërë në bazë të video incizimit e jo në bazë të asaj çfarë kishte parë ditën kritike. Në faqen 3 të aktgjykimit në rreshtin 30 ka theksuar se “në bazë të video incizimeve nuk ka mundur ta identifikoj” por identifikimin përmes fotografive në polici e ka bërë duke dyshuar se personi me numrin 5 është ai që e ka sulmuar. Deklarata e dëshmitarit S.S. nuk ka mundur të identifikoj K. H. si kryes të veprës dhe përshkrimin e sulmuesit e bën në bazë të video incizimit e që nuk është arritur asnjëherë të identifikohet sulmuesi e që vërtetohet edhe nga gjykata në faqen 5 në rreshtin e 20 të aktgjykimit e që përsëri gjykata e merr deklaratën e tij si fakt mbi të cilën e mbështet aktgjykimin. Edhe raporti policor vetëm përshkruan ngjarjen çka ka ndodh dhe veprimet e policisë e po ashtu nga bastisja e shtëpisë nuk është gjetur asnjë dëshmi për rastin në fjalë.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e atakuar si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, ashtu që vlerëson se ajo është e bazuar. Nga shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se asnjëra nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor nuk ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Siç del nga shkresat e lëndës gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e saj e ka bazuar vetëm në deklaratën e të dëmtuarës A.I. të dhënë në procesverbalin në polici me rastin e identifikimit të dëmtuarit përmes xhamit vezullues, dëshmi kjo e cila nëpër faza të procedurës ka pas kundërthënie e që është dashur nga ana e kryetarit të trupit gjykues ta ballafaqoj me procesverbalin e nënshkruar me atë të dhënë në shqyrtim kryesor e që përfundimisht me rastin e identifikimit të akuzuarit në sallë të gjykimit e njëjta ka deklaruar se në sigurinë e saj është 50% me 50%. Nga dëshmia e dëshmitarit S.S. nuk mundi të vërtetohet se i akuzuari K.H. është kryes i kësaj vepre penale pasi që i njëjti përveç që ka përshkruar ngjarjen sa i përket identifikimit nuk ka mundur ta bëjë përshkrimin e as identifikimin e personit që ka kryer veprën. Nga provat materiale vërtetohen vetëm veprimet që janë marrë nga ana e policisë siç është rasti me raportin e policit hetues ndërsa nga raporti i vendit të ngjarjes po ashtu përshkruhet vetëm ngjarja. Prandaj bazuar edhe në dispozitën e nenit 262 par.2 të KPP, gjykata nuk mund ta shpall të akuzuarin fajtor vetëm në një deklaratë siç është rasti konkret e që përveç kësaj kjo deklaratë nuk është shumë bindëse kur kihet parasysh se e dëmtuara në sigurinë e saj ishte 50% me 50%, e që në raste të tilla nuk e krijojnë standardin e mjaftueshëm të dyshimit mirë të bazuar e që është i nevojshëm që dikush të shpallët fajtor dhe të gjykohej në të kundërtën do të kishim një pasiguri juridike.

Prandaj bazuar në ato që u cekën më lart e duke marrë parasysh faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit e duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPP., *parimin e prezumimit të*

pafajësisë dhe parimin In Dubio Pro Reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë në dëm të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të bazuar dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet të konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë në favor të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.126/2018, më 07.05.2018

Procesmbajtësja,
Eroll Gashi_____

Kryetari i kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala_____